



**Udhëzues për veprimtarinë  
e komisioneve multidisiplinare  
për vlerësimin e nevojave  
të nxënësve me aftësi të kufizuara**

2024

Shkurt, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1448 /  
12 prot.

Tiranë, më 14 / 03 .2024

MIRATOHET

ZËVENDËSMINISTËR

NINA GUGA



**UDHËZUES PËR VEPRIMTARINË  
E KOMISIONEVE MULTIDISCIPLINARE  
PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE TË NXËNËSVE  
ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Shkurt, 2024

Dokumenti “Udhëzues për veprimtarinë e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara” u hartua nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

**Hartimi i dokumentit u koordinua nga:**

Esion Zgjana

**Përgatitja e dokumentit:**

Olta Jaçellari

Orsjola Miha

Rezarta Pullazi

**Redaktimi letrar:**

Zija Kurti

**Redaktimi shkencor:**

Esion Zgjana

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

# PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	4
SHKURTESA.....	6
HYRJE.....	7
KUADRI LIGJOR PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA .....	9
Ligji 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).....	11
Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” .....	12
Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR).....	13
NGRITJA E KMD-SË.....	14
FUNKSIONIMI I KMD-SË.....	15
VEPRIMTARIA E KMD-SË.....	17
PROCESI I VLERËSIMIT DHE I RIVLERËSIMIT.....	20
PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË VLERËSIMIT.....	22
DOKUMENTIMI I VLERËSIMIT .....	27
Dosja e nxënësit.....	27
Ruajtja e dokumentacionit.....	28
Baza e të dhënave .....	29
REKOMANDIMET .....	31
TRAJTIMI I RASTET E VEÇANTA.....	33
Vlerësimi i fëmijëve të arsimit parashkollor, moshë 3-6 vjeç.....	33
Vlerësimi i nxënësve të regjistruar në institucionet e arsimit special.....	34
Vlerësimi i nxënësve me kërkesë të përsëritur të personit që ushtron përgjegjësinë prindërore ose të drejtorit të institucionit arsimor .....	34
Vlerësimi i nxënësit që është regjistruar në shkollë mbi moshën e parashikuar në ligj.....	35

NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT PËR AFTËSINË E KUFIZUAR NË IA .....	36
KLASAT BURIMORE .....	38
SHTOJCA.....	39
Shtojca 1 - Ngritja e komisionit për nxënësit me aftësi të kufizuara nga institucioni arsimor	40
Shtojca 2a - Plani vjetor i KMD-së.....	41
Shtojca 2b - Model plani vjetor i KMD-së.....	43
Shtojca 3 - Tabela për bazën e të dhënave të KMD-së.....	45
Shtojca 4 - Rekomandim për ndjekjen e arsimit të zakonshëm .....	46
Shtojca 5 - Rekomandim për ndjekjen e arsimit special.....	48
Shtojca 6 - Rekomandim për pajisjen me raport mjeko-ligjor .....	50
Shtojca 7 - Vlerësimi periodik nga komisioni i shkollës për AK.....	52
Shtojca 8 - Kërkesë për vlerësim nga IA-ja.....	55
Shtojca 9 - Kërkesë për vlerësim nga prindi.....	56
Shtojca 10 - Formulari i vlerësimit të gjendjes fillestare për nxënësit me AK për klasat I-XII	57
Shtojca 11 - Formulari i vlerësimit të ecurisë për nxënësit me AK për klasat I-XII (rivlerësimi).....	65
Shtojca 12 - Formulari i vlerësimit të gjendjes fillestare për nxënësit me AK për arsimin parashkollor.....	71
Shtojca 13 - Formulari i vlerësimit të ecurisë për nxënësit me AK për arsimin parashkollor (rivlerësimi).....	79

# SHKURTESA

---

<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>DRAP</b>	Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar
<b>ZVAP</b>	Zyra vendore e arsimit parauniversitar
<b>IA</b>	Institucioni arsimor
<b>NJShPSSH</b>	Njësia e shërbimit psiko-social në shkollë
<b>PShPSSH</b>	Punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë
<b>PSh</b>	Psikologu shkollor
<b>PSSH</b>	Punonjësi social shkollor
<b>KMD</b>	Komisioni multidisiplinar
<b>AK</b>	Aftësia e kufizuar
<b>PEI</b>	Plani edukativ individual
<b>KML</b>	Komisioni mjeko-ligjor
<b>KMCAP</b>	Komisioni i caktimit të aftësisë për punë
<b>PMS</b>	Plani i modifikimit të sjelljes
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit
<b>KNF-FR (ICF-CY)</b>	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për fëmijët dhe adoleshentët


# HYRJE

---

Ky dokument është një udhëzues praktik, mbi procedurat që duhen të ndiqen nga komisionet multidisiplinare (KMD) pranë ZVAP-ve dhe nga punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor, në identifikimin, në vlerësimin, në ofrimin e shërbimeve për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe garantimin e gjithëpërfshirjes. Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton një mjedis të të nxëniet që mundëson akses, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit, që shkollat duhet të përshtaten për ta, pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore apo kushteve të tjera. Arsimi gjithëpërfshirës është një nga pjesët përbërëse të arsimit cilësor dhe ka në qendër fëmijën dhe përmbushjen e nevojave të tyre arsimore.

Udhëzuesi përshkruan veprimtarinë e komisionit multidisiplinar, të komisionit për aftësinë e kufizuar në IA, mënyrën e vlerësimit të nevojave arsimore dhe vlerësimin e ecurisë për këta fëmijë. Hartimi i këtij udhëzuesi erdhi si domosdoshmëri, për të unifikuar procedurën vlerësuese dhe instrumentet me të cilat KMD-ja vlerëson nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Komisionet multidisiplinare kanë filluar veprimtarinë e tyre në vitin shkollor 2013-2014, pas plotësimit me aktet nënligjore të ligjit 69/2012 për arsimin parauniversitar. Veprimtaria e KMD-së u zhvillua në përputhje me përcaktimet e Dispozitave Normative (2013) dhe gjithë procedura dhe instrumentet vlerësuese u hartuan nga anëtarët e KMD-ve, bazuar në detyrat e tyre funksionale dhe përcaktimet ligjore në fuqi, lidhur me aftësinë e kufizuar. Prej fillimit të veprimtarisë dhe deri më tani, KMD-të nuk kanë pasur instrumente vlerësuese të unifikuara dhe procedura e vlerësimit është zhvilluar në përshtatje me kushtet dhe me nevojat lokale.

Udhëzuesi synon të ofrojë një kornizë të unifikuar veprimesh institucionale, të cilat janë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe në mbështetje të zhvillimit të potencialit të tyre personal dhe social.



Udhëzuesi përmban formate të instrumenteve për vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve me AK, të mbështetura në *klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, të aftësisë së kufizuar dhe shëndetit, në variantin për fëmijë dhe të rinj*.

Udhëzuesi është hartuar në përputhje me standardet profesionale dhe me parimet etike. Procedura e vlerësimit paraqitet në mënyrë të qartë e të kuptueshme, udhëzon anëtarët e KMD-së dhe punonjësit psiko-socialë në institucionet arsimore, për realizimin e një procesi vlerësimi të unifikuar, të matshëm, efektiv, si dhe garanton marrjen e të dhënave mbi ecurinë e fëmijës me AK.

Ky udhëzues iu vjen në ndihmë anëtarëve të komisioneve multidisiplinare pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), komisionit të aftësisë së kufizuar në shkollë, punonjësve të shërbimit psiko-social etj.



# KUADRI LIGJOR PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

---

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** sanksionon në nenin 18 të saj, se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe, të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar, se kushdo ka të drejtën për arsimim, se arsimiti shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj, arsimiti i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë dhe arsimiti i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.
- **Konventa OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”**, ratifikuar me ligjin nr.7842, datë 3.12.2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar, bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe të sigurojë, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë, të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.
- VKM-ja nr.659, datë 3.11.2021 ka miratuar “Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF)”.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- VKM-ja nr.621 datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar 2021-2026”.
- VKM-ja nr. 659, datë 3.11.2021, “Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve”.

- Vendimi nr. 276, datë 12.5.2021, “Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2021 – 2026”.
- Konventa e OKB-së për të drejtat e PAK-ut.
- VKM-ja nr.380, datë 5.6.2019, “Për miratimin e dokumentit politik reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij”.
- Udhëzim nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
- Manuali i punës për punonjësit e njësisë së shërbimit psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar, 2020.
- Save The Children (2016). “Instrumentet e diagnostikimit të çrregullimeve neuro-zhvillimore te fëmijët e moshës 5-10 vjeç”.
- American Psychiatric Association, (2013). Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, 5th Edition: DSM.
- Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Urdhri nr.313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, të pezullimit dhe të largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar.
- Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor. (MAS, ASCAP 2022).
- Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkollor (MAS, ASCAP 2022).
- Parimet për etikën profesionale të shërbimit psiko-social shkollor (MAS, ASCAP 2022).
- Klasifikimi Ndërkombëtar i funksionimit, Aftësisë së kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijë dhe të Rinjtë: KNF-FR (OBSH 2007).

# Ligji 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)

Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore të specializuara për ta, është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe në shkollat e zakonshme të arsimit bazë, është parësore. Nxënësve që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail. Ky ligj rregullon arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes përcaktimeve në nenet:

## **Neni 64 - Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara**

1. Nxënësve me aftësi të kufizuara iu sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kriterëve të miratuara nga ministri i Arsimit dhe ministri i Shëndetësisë.
2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkollë të specializuara, deri në moshën 19 vjeç.
3. Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.
4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara, do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkollë fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.
5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit dhe komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.

6. Njësia arsimore vendore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Arsimit dhe të ministrit të Shëndetësisë, u siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundin të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.

#### **Neni 65 - Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara**

1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor dhe programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor dhe programeve lëndore të specializuara për ta.
2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara, hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënësve të institucionit dhe psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësve. Ndryshimi i programit të personalizuar, brenda një institucioni arsimor, vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.
3. Nxënësve me aftësi të kufizuara iu sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.
4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara, mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënësve, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

## **Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”**

Ky urdhër rregullon arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në kreun XIV, nenet 80 deri 87, dhe i shërben lehtësimit të punës për ofrimin sa më cilësor të shërbimeve për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në të përshkruhet mënyra si ngrihet komisioni multidisiplinar dhe detyrat e tij, detyrat e zyrave arsimore, detyrat e mësuesve ndihmës

në shkollat e zakonshme, si ngrihet dhe funksionon komisioni për aftësinë e kufizuar në shkollat e zakonshme, si e ndjekin shkollën dhe si kryhet vlerësimi për nxënësit me aftësi të kufizuara, si ofrohen shërbimet arsimore në shkollat e specializuara dhe cilat janë detyrat e mësuesve ndihmës në këto shkolla.

## **Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR)**

Ky udhëzues dhe instrumentet e vlerësimit të përfshira janë ndërtuar, bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR), nga i cili janë përzgjedhur ata tregues, që ndihmojnë në vlerësimin e nevojave arsimore, për nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Ky vlerësim realizohet nga komisioni multidisiplinar për aftësinë e kufizuar, i ngritur pranë çdo njësie arsimore vendore.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR) sjell në dukje një pamje më të gjerë të shëndetit, thekson komponentët funksionalë të gjendjes klinike dhe i përshkruan ata plotësisht, lehtëson planifikimin e ngjarjeve, duke ua bashkëngjitur profileve klinike dhe duke identifikuar fokusin e ndërhyrjeve, siguron informacion sipas perspektivave të ndryshme të ekipit multidisiplinar, përfshirë ato të fëmijës dhe të familjes së tij, dhe plotëson ICD-10 (*International Classification of Diseases*).

Referuar faktit se KMD-ja vlerëson nevojat arsimore të fëmijës, i cili është diagnostikuar më parë nga një komision bio-psiko-social ose mjeko-ligjor, instrumentet e hartuara dhe të përfshira në këtë udhëzues, përmbajnë vetëm ato fusha të cilat i shërbejnë vlerësimit dhe plotësimin të nevojave arsimore të fëmijëve të vlerësuar dhe janë brenda fushës së kompetencës për anëtarët e KMD-së.

# NGRITJA E KMD-SË

---

Komisioni multidisiplinar (KMD) për AK pranë ZVAP-së, ngrihet, funksionon dhe zbaton detyrimet që i ngarkohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për arsimimin e fëmijëve me AK.

Komisioni ngrihet nga njësia arsimore vendore (ZVAP) dhe ka në përbërje një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin special). Kryetari i KMD-së caktohet një nga psikologët/punonjësit socialë të shkollave në juridiksion të ZVAP-së, i propozuar nga drejtuesi i NjShPS-ës të DRAP-it.

ZVAP-ja, në bazë të numrit të institucioneve arsimore nën juridiksionin e vetë dhe në bazë të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara, mund të ngrejë më shumë se një komision për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim.

KMD-ja nuk është e nevojshme të ringrihet në fillim të çdo viti shkollor, por vetëm në rastet kur anëtarë të komisionit tërhiqen nga të qenit anëtarë, atëherë ZVAP-ja ringre komisionin, duke zëvendësuar anëtarin që mungon.

Komisioni vlerëson nxënësin me aftësi të kufizuara, pasi prindi/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ose drejtori i IA-së ku fëmija është i regjistruar, ka paraqitur pranë ZVAP-së, kërkesën me shkrim për vlerësim ose rivlerësim të nxënësit. Pas marrjes në shqyrtim të kërkesës, KMD-ja vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij.

KMD-ja harton, organizon dhe ruan një bazë të dhënash për çdo fëmijë të vlerësuar, për çdo vit shkollor. Baza e të dhënave përmban të dhëna, si: institucioni arsimor ku nxënësi ndjek mësimet, emri, atësia, mbiemri, gjinia, klasa, diagnoza (sipas raportit mjekësor), data kur ka kryer vlerësimin dhe rekomandimet e dhëna për secilin nxënë. Kjo bazë të dhënash ruhet për të krijuar mundësinë e krahasimit të të dhënave dhe ecurinë vit pas viti për çdo nxënë të vlerësuar.

# FUNKSIONIMI I KMD-SË

---

Komisioni mbledhet të paktën 3 herë në çdo vit shkollor: në fillim të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor.

1. Në fillim të vitit shkollor, KMD-ja shqyrton kërkesat e paraqitura nga prindi/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore (Shtojca 9) ose drejtori i IA-së (Shtojca 8) dhe vlerëson nevojat për ata nxënës me AK, të cilët janë regjistruar për herë të parë në IA (në klasën përgatitore, klasën e 1-rë dhe klasën e 10-të) ose nxënës të cilët janë pajisur për herë të parë me raport mjekësor (në klasat e ndërmjetme). Vlerësimi fillestar i nevojave arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara, kryhet në fillimit të çdo niveli arsimor (kur regjistrohet për herë të parë në kopsht, në klasën e parë dhe në shkollën e mesme).

Gjithashtu, në këtë fazë vlerësimi, KMD-ja shqyrton kërkesat e paraqitura nga prindi/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ose drejtori i IA-së dhe vlerëson nevojat për ata fëmijë me AK që ndjekin arsimin parashkollor.

Kjo fazë vlerësimi përfundon, jo më vonë se 4 (katër) javë nga data e fillimit të vitit shkollor, referuar numrit të nxënësve që duhet të vlerësohen nga KMD-ja dhe kohës që i duhet institucionit arsimor të mbledhë të dhënat dhe të paraqesë kërkesën për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

2. Në fund të periudhës së parë, KMD-ja vlerëson ata nxënës të vlerësuar më parë nga KMD-ja, të cilët, gjatë kësaj periudhe, kanë paraqitur vështirësi ose iu kanë ndryshuar nevojat dhe prindi/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ose drejtori i shkollës ka bërë kërkesë për rivlerësim.

Gjithashtu, në këtë fazë, KMD-ja vlerëson nxënës të cilët gjatë kësaj periudhe janë identifikuar me vështirësi (pavarësisht nëse janë apo jo të pajisur me raport mjekësor) dhe është kërkuar nga prindi ose drejtori i IA-së, të vlerësohen nga

KMD-ja, si dhe nxënës që janë pajisur me raport mjekësor për herë të parë gjatë kësaj periudhe.

Kjo fazë vlerësimi realizohet në varësi të numrit të kërkesave të ardhura pranë ZVAP-ve.

3. Në fund të vitit mësimor, KMD-ja vlerëson nxënësit me AK të cilët janë vlerësuar më parë nga komisioni dhe gjatë vitit mësimor janë ndjekur me mësues ndihmës. Në këtë fazë vlerësimi, KMD-ja vlerëson ecurinë e nxënësit, bazuar në planin PEI, vlerësimin e ecurisë që komisioni i AK-së në shkollë ka kryer për nxënësin në fund të çdo periudhe (Shtojca 7) dhe vlerësimin nga punonjësi ShPS-ës i shkollës. Në përfundim të kësaj faze, rivlerësohen nevojat e fëmijës dhe KMD-ja jep rekomandimet përkatëse për hartimin e planit PEI në vazhdimësi, për numrin e orëve mësimore dhe shërbime të tjera të vlerësuara të nevojshme që fëmija mund t'i marrë jashtë IA-së.

Kjo fazë vlerësimi fillon rreth 4 (katër) javë para përfundimit të vitit shkollor, referuar numrit të nxënësve që duhet të vlerësohen nga KMD-ja dhe kohës që i duhet institucionit arsimor, të përgatisë dosjet personale të nxënësve me të dhënat përkatëse të nevojshme, për vlerësimin e ecurisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

4. KMD-ja ka të detyrueshme të mblidhet të paktën 3 (tre) herë brenda vitit shkollor, sipas fazave të përshkruara më sipër, por KMD-ja, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve dhe nevojat specifike të tyre, të cilat mund të ndryshojnë për shkaqe dhe rrethana të ndryshme, mund të mblidhet në raste të veçanta ose urgjente, për të vlerësuar ose për të rivlerësuar nevojat e nxënësve, pas kërkesës së bërë në ZVAP.



# VEPRIMTARIA E KMD-SË

---

Veprimtaria e KMD-së shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor, me qëllim planifikimin e veprimtarisë vjetore (Shtojca 2), marrjen në dorëzim të kërkesave për vlerësim nga ZVAP-ja, shqyrtimin e tyre, organizimin e punës për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve me AK, dokumentimin e procesit të vlerësimit dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për nxënës të vlerësuar.

Para fillimit të vitit shkollor, KMD-ja mblidhet për të realizuar planifikimin e veprimtarisë vjetore. Pjesë e këtij planifikimi është edhe hartimi i një plani vjetor (Shtojca 2) për veprimtarinë e komisionit. Ky plan mund të përmbajë veprimtari, të tilla si: afatet e fazave të vlerësimit në varësi të numrit të nxënësve me AK, takime për plotësim të dokumentacionit, ngritjen e bazës së të dhënave dhe përditësimin e saj pas çdo faze vlerësimi, si dhe takime të planifikuara në varësi të nevojave të komisionit.

Plani vjetor hartohet nga kryetari i KMD-së në bashkëpunim me anëtarët dhe miratohet nga titullari i ZVAP-së. Kur ZVAP-ja ngre dy ose më shumë komisione multidisiplinare, ato funksionojnë sipas një plani të përbashkët, të hartuar nga kryetarët e KMD-ve dhe të miratuar nga titullari i ZVAP-së.

ZVAP-të janë institucionet përgjegjëse për mbledhjen e kërkesave nga prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore ose nga drejtuesit e IA-së.

ZVAP-ja, pasi ka marrë në dorëzim kërkesat e paraqitura për vlerësim, ia dorëzon KMD-së, dy javë përpara fillimit të procesit të vlerësimit, në mënyrë që KMD-ja të fillojë shqyrtimin e tyre. Marrja e kërkesave nga ZVAP-ja, shënon fillimin e secilës prej fazave të vlerësimit.

KMD-ja, pasi vlerëson të gjitha kërkesat e marra në shqyrtim, i dorëzon ZVAP-së kalendarin e vlerësimit, në të cilin parashikon datat dhe orën e vlerësimit për nxënësit e çdo institucioni arsimor.

Gjatë hartimit të kalendarit, KMD-ja kujdeset që koha në dispozicion të procesit të vlerësimit të nevojave arsimore për çdo nxënës të jetë e mjaftueshme.

ZVAP-ja iu përcjell kalendarin e vlerësimit, institucioneve arsimore, të cilat më pas, janë përgjegjëse për njoftimin e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

ZVAP-ja është përgjegjëse për sigurimin e një mjedisi vlerësimi të përshtatshëm dhe të bazës materiale të nevojshme për vlerësim. ZVAP-ja kujdeset që vendi i përzgjedhur për kryerjen e procesit të vlerësimit të jetë një mjedis i përshtatshëm, lehtësisht i aksesueshëm nga fëmijët dhe prindërit, si dhe siguron për komisionet multidisiplinare mjetet didaktike në funksion të procesit të vlerësimit.

Në rastet kur ZVAP-ja, për shkak të numrit të lartë të institucioneve arsimore dhe/ose numrit të lartë të nxënësve më AK, ngre më shumë se një komision, kujdeset që mjediset e caktuara për vlerësim, të lehtësojnë vlerësimin e nxënësve për institucionet arsimore të një ose disa njësive administrative.

ZVAP-ja, pasi merr nga komisioni rekomandimet (Shtojca 4, 5 dhe 6), për çdo nxënës me AK, për orët mësimore me mbështetje të mësuesit ndihmës, i përcjell ato pranë institucioneve arsimore ose personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, në rastet kur ky i fundit ka bërë kërkesë për vlerësimin e fëmijës nga KMD-ja.

Institucionet arsimore janë përgjegjëse për informimin e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore mbi rekomandimet e KMD-së.

KMD-ja, pasi merr në dorëzim kërkesat për vlerësim organizon punën për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve me AK. Organizimi i punës përfshin:

- Mbledhjen e komisionit për përcaktimin e agjendës për atë fazë vlerësimi.
- Shqyrtimin e kërkesave dhe i dokumentacionit që është kërkuar të dorëzohet paraprakisht.
- Hartimin e kalendarit për vlerësimin e nxënësve, duke përcaktuar kohëzgjatjen e fazës së vlerësimit.
- Fillimin e procesit të vlerësimit, pas njoftimit të institucioneve arsimore nga ZVAP-ja.

- Pasi ka përfunduar procesin e vlerësimit, plotësimin e rekomandimeve përkatëse për çdo nxënës të vlerësuar, si dhe përditësimin e bazës së të dhënave e cila përmban rekomandimet për llojin e arsimit, orët mësimore me mbështetje të mësuesit ndihmës, ndjekjen ose jo me PEI dhe shërbime të tjera për të cilat nxënësi ka nevojë.
- Tabelën e bazës së të dhënave me rekomandimin për orët mësimore me mbështetje të mësuesit ndihmës, që i dorëzohet drejtuesit të ZVAP-së (Shtojca 3).
- Në përfundim të secilës prej fazave të vlerësimit komisioni përditëson dosjet e nxënësve të vlerësuar (shënim: çdo nxënës më AK vlerësohet nga KMD-ja një herë për çdo vit shkollor, por në rast se është e nevojshme mund të rivlerësohet me kërkesë nga drejtori i IA-së ose personi që ushtron përgjegjësinë prindërore).

# PROCESI I VLERËSIMIT DHE I RIVLERËSIMIT

---

KMD-ja, gjatë vlerësimit të nevojave arsimore, synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së nxënësve me AK, për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe aftësimin për punë. KMD-ja vlerëson nevojat arsimore të nxënësve, duke iu referuar:


- specifikave të diagnozës sipas raportit mjekësor;
- vlerësimit psikologjik nga psikologu i IA-së;
- performancës së nxënësit gjatë vlerësimit, duke aplikuar instrumente vlerësimi, mbështetur në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit.

Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni mbledh të dhëna që i shërbejnë procesit, nga prindi dhe mësuesi që shoqëron fëmijën gjatë vlerësimit.

Vlerësimi fillestar (Shtojca 10) i nxënësit me AK, kryet vetëm një herë, kur nxënësi vlerësohet për herë të parë nga KMD-ja, dhe shoqërohet me ruajtjen e dokumentacionit përkatës. Ecuria e nxënësit rivlerësohet vit pas viti (Shtojca 11) zakonisht, në fund të vitit shkollor (sidomos për rastet kur duhet të vlerësohet një numër i lartë nxënësish), në mënyrë që të realizohet në kohë plotësimi i nevojave që në fillim të vitit shkollor pasardhës.

Gjatë procesit të rivlerësimit të nevojave, KMD-ja mbledh të dhëna mbi:

- vlefshmërinë e raportit mjekësor,
- ndryshime të mundshme të diagnozës,
- specifika nga vlerësimi psikologjik i psikologut të IA-së,
- të dhëna mbi ecurinë e nxënësit, nga komisioni për aftësinë e kufizuar në IA.



Ky proces mbështetet në ecurinë e fëmijës, sipas programit mësimor me të cilin ka punuar nxënësi gjatë vitit shkollor, në vështirësitë dhe problematikat sjellore, në efektivitetin e orëve mësimore që ka punuar me mësues ndihmës dhe në ndjekjen e shërbimeve të nevojshme që mund të jenë rekomanduar gjatë vlerësimit të mëparshëm.

Gjatë procesit të vlerësimi fillestar dhe të procesit të rivlerësimit, KMD-ja udhëzon punonjësin e shërbimit psiko-social të shkollës (i cili është kryetar i komisionit për AK në IA) ku mëson nxënësi me AK, për programin mësimor me të cilin nxënësi duhet të mësojë, kohën dhe nevojën e përdorimit të mjediseve të veçanta burimore brenda shkollës etj.

# PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË VLERËSIMIT

---

Instrumentet e vlerësimit ku KMD-ja (Shtojcat 10, 11, 12 dhe 13) bazohet, janë ndërtuar bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe të Rinjtë (KNF-FR), nga i cili janë përzgjedhur ata tregues, që ndihmojnë në vlerësimin e nevojave arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.

Instrumenti është i organizuar në pjesë si vijon:

## ***1. Të dhënat e përgjithshme të fëmijës***

Në këtë pjesë, komisioni paraqet të dhënat e marra gjatë vlerësimit, që kanë të bëjnë me: datën e vlerësimit, klasën dhe institucionin arsimor; të dhënat personale (emër, atësi, mbiemër, datëlindja); të dhëna mbi diagnozën kryesore dhe diagnoza shoqëruese nëse ka; llojin e raportit mjekësor, afatin e vlefshmërisë, si dhe me adresën e banimit dhe një numër kontakti me prindërit.

KMD-ja e mbledh këtë informacion, para fillimit të procesit të vlerësimit të fëmijës, nga intervista me prindërit.

## ***2. Të dhëna për jetën dhe historikun e diagnostikimit***

Në këtë pjesë të formularit, paraqiten të dhënat e mbledhura nga intervista me prindin. Këto të dhëna synojnë të ndihmojnë anëtarët e KMD-së, të njohin më mirë kushtet sociale dhe ekonomike në të cilat jeton nxënësi (si: numri i anëtarëve të familjes, gjendja social-ekonomike e familjes, kush kujdeset më shumë për fëmijën, me kë është më i lidhur fëmija etj.).

Gjithashtu, me rëndësi është njohja e historikut të diagnostikimit dhe të trajtimit (mosha kur është diagnostikuar për herë të parë, trajtimet e marra, të dhëna specifike rreth diagnozës).

Për të plotësuar tablonë e vlerësimit, komisioni merr informacion mbi nevoja specifike, lidhur me qëndrimin në shkollë (largimi nga mjedisi, çfarë e qetëson/shqetëson), ecurinë e nxënësit gjatë periudhës që ka frekuentuar shkollën, përshtatja, të nxënës, sjellja, reagimi emocional), si dhe manifestimet sjellore dhe kushtet në të cilat i shfaq ato.

Gjithashtu, komisioni kujdeset të marrë të dhëna specifike mbi llojin e trajtimeve me terapi apo të medikamenteve që fëmija merr, përdorimin e mjeteve në ndihmë të aftësisë së kufizuar (në të parë, në të dëgjuar, motorikë globale) dhe, në bazë të këtyre të dhënave, bën një konstatim të përgjithshëm, nëse gjendja e fëmijës është e qëndrueshme, në përkeqësim apo në përmirësim.

### ***3. Vlerësimi sipas fushave (funksionet mendore, aftësitë dhe performanca shkollore, faktorët lehtësues dhe pengues***

Kjo pjesë e formularit plotësohet hap pas hapi, gjatë procesit të vlerësimit, i cili përfshin intervistimin e prindit, vlerësimin e fëmijës përmes provave, duke përcaktuar për çdo tregues praninë ose jo të problemit, dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit, ku në 0 - problemi mungon (nuk ka, mungon, i papërfillshëm), 1 - problemi është i lehtë (i pakët, i ulët), 2 - problemi është mesatar (mesatar, i konsiderueshëm), 3 - problemi është i rëndë (i lartë, ekstrem), 4 - problemi është i plotë (total).

Në këtë sesion, KMD-ja paraqet të dhënat e vlerësimit mbi funksionet mendore të kategorizuara në:

*Funksionet globale mendore:* Vetëdija, orientimi, intelekti, aftësia për t'u përfshirë dhe funksionet e gjumit.

*Funksionet mendore specifike:* Vëmendja, kujtesa, funksionet psiko-motore, funksionet emocionale, funksionet e perceptimit, funksionet e mendimit, përvoja e vetvetes dhe funksionet e kohës.

*Të mësuarit dhe zbatimi i njohurive:* Aftësia për të mësuar nëpërmjet veprimeve me objekte, aftësia për të mësuar gjuhën, aftësia për të mësuar nga përsëritja/bërja e disa provave, mësimi i koncepteve, mësimi i leximit, mësimi i shkrimit, mësimi i veprimeve me numra, mësimi/përftimi i aftësive bazë.

*Detyra dhe kërkesa të përgjithshme:* Kryerja e një detyre të vetme me një komandë, ndërmarrja e detyrave të shumta që përfshijnë disa komanda, kryerja e rutinës së përditshme, përballimi i stresit dhe i kërkesave psikologjike, kontrolli i sjelljes së vetvetes.

*Komunikimi:* Aftësia për të marrë mesazhet verbale/përmes të folurit, aftësia për të marrë mesazhet joverbale, të folurit, prodhimi i mesazheve joverbale, aftësia për të biseduar.

*Lëvizshmëria:* Ndryshimi i pozicionit të trupit, ruajtja e pozicionit të trupit, zhvendosja e trupit, përdorimi me imtësi të dorës, përdorimi i dorës dhe i krahut, ecja, ekuilibri.

*Vetëkujdesi:* larja e vetes, kryerja e nevojave personale, veshja, ngrënia, pirja, kujdesi për sigurinë e vetes, kujdesi për sigurinë e dikujt tjetër.

*Aspektet kryesore të jetës:* Angazhimi në jetën shkollore dhe veprimtaritë që lidhen me të, angazhimi në lojë, lojëra vetëm, lojëra të përbashkëta, pjesëmarrja në sporte, ndërveprimet bazë ndërpersonale.

Komisioni, përmes informacionit të marrë nga prindi, përcakton ndikimin e disa faktorëve mjedisorë që ndikojnë në zhvillimin dhe ecurinë e fëmijës, për të cilët duhet të vlerësohet, nëse janë faktorë pengues ose lehtësues për zhvillimin e potencialit të fëmijës. Këta faktorë janë të kategorizuara në:

*Produktet dhe teknologjia:* Ushqyerja, trajtimi me ilaçet e nevojshme në rastet e rekomanduara nga mjeku, përdorimi i teknologjisë për të luajtur, përdorimi i teknologjisë për komunikim, mjete apo materiale didaktike në dispozicion për edukimin, qasja në mjediset publike, përshtatshmëria e vendit ku jeton fëmija.



*Mbështetja dhe marrëdhëniet:* Mbështetja e rrethit të ngushtë familjar, mbështetja e rrethit të gjerë familjar, mbështetja e shokëve, mbështetja e të njohurve, e fqinjëve dhe e pjesëtarëve të tjerë të komunitetit.

#### **4. Specifika lidhur me qëndrimin në shkollë**

Komisioni, përmes informacionit të marrë nga prindi dhe punonjësi i shërbimit psiko-social i shkollës, vlerëson mbi specifika që lidhen me qëndrimin në shkollë, vlerëson mundësinë e qëndrimit të pavarur dhe aftësitë për t'u kujdesur për veten në mjedisin e klasës/shkollës. Gjithashtu, komisioni vlerëson mbi aftësitë e nxënësit për të punuar me programin standard të klasës apo nevojën për të punuar me kurrikul të përshtatur ose me PEI-n.

#### **5. Shënime specifike mbi fëmijën/nxënësin**

Në këtë sesion, komisioni mban shënime të cilat i vlerëson të nevojshme dhe të dobishme për t'i ardhur në ndihmë fëmijës.

#### **6. Rekomandime lidhur me arsimimin dhe shërbime të tjera**

Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni jep rekomandimet e nevojshme, mbështetur në nevojat arsimore të vlerësuara, gjendjes së përgjithshme të fëmijës, përshtatjen dhe ecurinë në institucionin arsimor. Rekomandimet jepen për llojin e arsimit që do të ndjekë fëmija (i zakonshëm ose special), nevojën për mbështetjen me mësues ndihmës dhe orët e rekomanduara, programin mësimor, përdorimin e klasës burimore dhe shërbime të tjera të nevojshme jashtë institucionit arsimor (terapi zhvillimi, terapi sjellore, logopedi etj.).

**Për vlerësimin e ecurisë (rivlerësimi)** komisioni përdor formatin (sipas Shtojcës 11), në të cilin procesi i vlerësimit përshkruhet në të njëjtën linjë si vlerësimi fillestar, duke vlerësuar ndryshimin e gjendjes së nxënësit, si dhe duke shtuar marrjen e të dhënave mbi ecurinë gjatë vitit shkollor, si:

- Niveli i përmbushjes së nevojave për numrin e orëve të asistuar;
- Niveli i frekuentimit të shkollës;
- Pavarësia gjatë procesit mësimor;

- Pavarësia gjatë qëndrimit në shkollë;
- Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së rezultateve të të nxënit sipas PEI-t (nëse është ndjekur me PEI-n);
- Koha e përdorimit të klasës burimore;
- Niveli i manifestimit të problematikave sjellore.

Në përfundim të vlerësimit, para se të japë rekomandimet, komisioni bën një konstatim të përgjithshëm, nëse gjendja e fëmijës gjatë vitit shkollor ka qenë e qëndrueshme, në përkeqësim apo në përmirësim.

Edhe në përfundim të vlerësimit të ecurisë (rivlerësimi), komisioni jep rekomandimet e nevojshme, mbështetur në nevojat arsimore të vlerësuara, gjendjes së përgjithshme të fëmijës, përshtatjen dhe ecurinë në institucionin arsimor.

E njëjta procedurë për vlerësimin e nevojave fillestare dhe vlerësimin e ecurisë, realizohet nga komisioni, edhe për fëmijët me aftësitë kufizuara në institucionet e arsimit parashkollor, sipas shtojcave përkatëse (Shtojca 12 dhe 13).

# DOKUMENTIMI I VLERËSIMIT

---

## Dosja e nxënësit

KMD-ja dokumenton rregullisht punën e vet në çdo fazë të vlerësimit, duke mbajtur të dhëna për paraqitjen e nxënësve në vlerësim, sipas kalendarit të njoftuar paraprakisht. KMD-ja dokumenton përmes procesverbalit, vetëm rastet kur janë prezente problematika të ndryshme, si:

- mosparaqitja e nxënësve në vlerësim,
- shoqërimi i nxënësit nga familjarë që nuk janë kujdestarë të ligjshëm,
- refuzimi i prindit për vlerësimin e fëmijës,
- etj.

KMD-ja ruan dokumentacionin e vlerësimit fillestar për çdo nxënës me AK të vlerësuar, i cili përmban:

- Kopje të raportit mjekësor të nxënësit.
- Vlerësimin nga psikologu/punonjësi social i shkollës.
- Formularin e plotësuar nga KMD-ja gjatë vlerësimit (Shtojcat 10, 11, 12 dhe 13).

KMD-ja përditëson dokumentacionin vit pas viti, duke shtuar në dosjen e çdo nxënësi, pas çdo rivlerësimi:

- Formularin e rivlerësimit të plotësuar nga KMD-ja.
- Kopje të rinovuar të raportit mjekësor.
- Kopje të vlerësimit të ecurisë për secilën periudhë mësimore, nga komisioni për aftësinë e kufizuar në IA.

KMD-ja mund të kërkojë shtesë çdo dokumentacion që e vlerëson të nevojshëm, në rastet kur kërkohet rivlerësim i disa nevojave specifike, nga ana e institucionit arsimor ose nga prindi.

KMD-ja përditëson dosjen e nxënësit me AK, sa herë që nxënësi paraqitet për vlerësim në këtë komision.

Duke qenë se ZVAP-ja është institucioni përgjegjës për sigurimin e mjedisit dhe të kushteve të përshtatshme të punës për KMD-në, duhet të sigurojë një mjedis të posaçëm, jo vetëm për realizimin e procesit të vlerësimit dhe garantimin e bazës materiale, por gjithashtu, duhet të sigurojë edhe një mjedis të përshtatshëm për ruajtjen/arkivimin e dosjeve të vlerësimit të çdo nxënësi me AK dhe bazën e të dhënave për çdo vit.

Dosja e nxënësit me AK, të vlerësuar nga KMD-ja, duhet të përmbajë:

- Formularin e plotësuar të vlerësimit fillestar të nevojave.
- Raportet mjekësore që ka paraqitur në çdo vlerësim pranë KMD-së.
- Formularin e plotësuar për çdo rivlerësim nevojash.
- Kopje të vlerësimit të ecurisë për secilën periudhë mësimore, nga komisioni për aftësinë e kufizuar në IA.
- Vlerësimin nga psikologu/punonjësi social i shkollës në vlerësimin fillestar.
- Vlerësimin nga psikologu/punonjësi social i shkollës, nëse KMD-ja e kërkon gjatë rivlerësimit, për shkak të ndryshimeve në nevojat e fëmijës me AK.

## **Ruajtja e dokumentacionit**

Dokumentacioni i hartuar dhe dokumentacioni i grumbulluar nga KMD-ja, janë të nevojshme të ruhen, të mirëmbahen dhe të plotësohen vit pas viti, për të siguruar të dhëna mbi ecurinë e nxënësve me AK gjatë gjithë viteve të shkollimit, për sa kohë nxënësi vijon të jetë pjesë e sistemit arsimor.

Në rastet ku nxënësi me AK është vlerësuar nga KMD-ja, se nuk ka më nevojë për mbështetje dhe ecuria e tij ka qenë shumë e mirë, KMD-ja e mbyll dosjen e nxënësit dhe nuk e përfshin në bazën e të dhënave të nxënësve me AK të vlerësuar prej tij.

## Baza e të dhënave

KMD-ja harton, organizon dhe ruan një bazë të dhënash për çdo fëmijë të vlerësuar, për çdo vit shkollor. Baza e të dhënave përmban të dhëna, si: institucioni arsimor ku nxënësi mëson, emri, atësia, mbiemri, gjinia, klasa, diagnoza, data e vlerësimit nga KMD-ja dhe rekomandimet për secilin nxënës të vlerësuar. Kjo bazë të dhënash ruhet për të krijuar mundësinë e krahasimit të të dhënave dhe të ecurisë së nxënësit vit pas viti, për çdo nxënës të vlerësuar (Shtojca 3). Baza e të dhënave, sipas tabelës në shtojcën 3, rekomandohet të mbahet në formatin EXEL, për lehtësi të menaxhimit të të dhënave të grumbulluara.

Tabela duhet të përmbajë *numrin rendor* të nxënësve të vlerësuar, *institucionin arsimor* ku nxënësi është i regjistruar, *datën* kur nxënësi është paraqitur për vlerësim pranë komisionit dhe *të dhënat e përgjithshme të fëmijës* (emri, atësia, mbiemri, gjinia, klasa).


*Të dhënat për diagnozën:* mbahen të dhëna për çdo diagnozë që nxënësi ka sipas raportit mjekësor.

*Lloji i raportit mjekësor:* mbahen të dhëna mbi llojin e raportit mjekësor, nëse është KML (nga Komisioni Mjeko-Ligjor), KMCAP (nga Komisioni Bio-Psiko-Social për caktimin e aftësisë për punë) etj.

Gjithashtu, tabela paraqet në mënyrë të përmbledhur rekomandimet që KMD-ja ka dhënë, lidhur me:

*Lloji i arsimit:* KMD-ja rekomandon mbi llojin e arsimit, të zakonshëm, special ose në kushte shtëpie, duke i shënuar me shkurtesa, AZ – arsim i zakonshëm, AS - arsim special dhe AKSh - arsim në kushte shtëpie.

*Lloji i programit:* KMD-ja rekomandon mbi llojin e programit mësimor me të cilin nxënësi me AK duhet të mësojë gjatë vitit shkollor, duke shënuar në tabelë për program i zakonshëm – PZ, program i reduktuar – PR ose plan edukativ individual – PEI.



*Nevoja për mësues ndihmës:* sipas rekomandimit të dhënë, ky zë i tabelës plotësohet me Po (kur është rekomanduar mësues ndihmës) ose Jo (kur nxënësi nuk e praqet nevojën për mësues ndihmës).

*Orë/javë:* sipas rekomandimit të dhënë shënohet numri i orëve mësimore me mbështetjen nga mësuesi ndihmës (p.sh., 10 orë/javë).


# REKOMANDIMET

---

Në përfundim të procesit të vlerësimit të nxënësve me AK, KMD-ja, pasi ka vlerësuar nevojat arsimore që paraqet nxënësi në momentin e vlerësimit, pasi është njohur me historikun e diagnostikimit dhe me specifikat e diagnozës, prezencën ose jo të diagnozave bashkëshoqëruese, historikun dhe trajtimin e nxënësit me terapi mjekësore, farmakologjike, terapeutike dhe ka plotësuar formularin me të dhënat për çdo fushë zhvillimi, duhet të japë rekomandimin përkatës, në përputhje me nevojat e vlerësuara (Shtojcat 4, 5 dhe 6). Mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, KMD-ja mund të japë rekomandime për:

- Llojin e arsimit (i zakonshëm ose i specializuar).
- Llojin e programit mësimor (programi i zakonshëm i klasës, program i reduktuar ose plan edukimi i individualizuar (PEI)).
- Nevojën për mësues ndihmës. Nëse vlerësohet prania e nevojës për mësues ndihmës, atëherë përcakton edhe numrin e orëve mësimore me mbështetje nga mësuesi ndihmës.
- Nevojën për përdorimin e klasës burimore. Nëse vlerësohet nevoja e përdorimit të klasës burimore, KMD-ja rekomandon kohën e përdorimit të saj.
- Shërbime të tjera mbështetëse jashtë IA-së.
- Pajisjen me raport mjeko-ligjor (nëse nuk ka).

Në përfundim të procesit të vlerësimit, KMD-ja përditëson bazën e të dhënave dhe plotëson rekomandimin përkatës për çdo nxënës. KMD-ja informon verbalisht, mbi rezultatet e vlerësimit, në përfundim të procesit, prindin/personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, i cili nënshkruan në formularin që KMD-ja plotëson për nxënësin gjatë vlerësimit. KMD-ja, në përfundim të procesit të vlerësimit, për të gjithë nxënësit, plotëson rekomandimet individuale të nënshkruara nga të gjithë anëtarët dhe ia përcjell ZVAP-së. ZVAP-ja është përgjegjëse për përcjelljen e rekomandimit pranë personit që ushtron përgjegjësinë prindërore ose institucionit arsimor që ka bërë



kërkesën për vlerësim. Institucioni arsimor është përgjegjës për ruajtjen e rekomandimeve të çdo nxënësit me AK dhe ka detyrimin të informojë, të përcjellë rekomandimin prindit /personit që ushtron përgjegjësinë prindërore.

Rekomandimi jepet vetëm në një kopje origjinale i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. KMD-ja ruan rekomandimet vetëm në formën e bazës së të dhënave, të cilat nënshkruhen nga anëtarët e komisionit në përfundim të çdo faze të vlerësimit.

KMD-ja ruan bazën e të dhënave vit pas viti, në formë elektronike dhe fizike për 5 (pesë) vitet e fundit shkollore.

Modele të rekomandimeve i gjeni në shtojcat e bashkëlidhura, të cilat mund të shërbejnë si model referimi, por, për raste specifike, komisioni mund të hartojë rekomandimin në përputhje me nevojat e vlerësuara.



# TRAJTIMI I RASTET E VEÇANTA

---

Komisioni multidisiplinar, krahas veprimtarisë vlerësuese tri herë në çdo vit shkollor, të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbledhet për të vlerësuar edhe në raste të veçanta, të cilat kërkojnë që procedura e vlerësimit të kryhet ndryshe nga ajo standarde.

## **Vlerësimi i fëmijëve të arsimit parashkollor, moshë 3-6 vjeç**

Në këtë rast, kërkesat për vlerësim i paraqiten ZVAP-ve, të cilat janë institucionet përgjegjëse për mbledhjen e kërkesave nga prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore ose nga drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor. ZVAP-ja, pasi ka marrë në dorëzim kërkesat e paraqitura për vlerësim, ia dorëzon KMD-së, dy javë përpara fillimit të procesit të vlerësimit, në mënyrë që KMD-ja të fillojë shqyrtimin e tyre. Marrja e kërkesave nga ZVAP-ja, shënon fillimin e procesit të vlerësimit të fëmijëve në arsimin parashkollor, të moshës 3 deri 6 vjeç. KMD-ja, pasi vlerëson të gjitha kërkesat e marra në shqyrtim, i dorëzon ZVAP-së kalendarin e vlerësimit, në të cilin parashikon datat dhe orën e vlerësimit për fëmijët e çdo institucioni të arsimit parashkollor. Gjatë hartimit të kalendarit, KMD-ja kujdeset që koha në dispozicion të procesit të vlerësimit të nevojave arsimore për çdo fëmijë, të jetë e mjaftueshme. ZVAP-të iu përcjellin kalendarin e vlerësimit, institucioneve të arsimit parashkollor, të cilat më pas, janë përgjegjëse për njoftimin e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

ZVAP-të në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për arsimin parashkollor, në njësinë administrative, janë përgjegjëse për sigurimin e një mjedisi vlerësimi të përshtatshëm dhe bazës materiale të nevojshme për vlerësim. Ato kujdesen që vendi i përzgjedhur për kryerjen e procesit të vlerësimit të jetë një mjedis i përshtatshëm, lehtësisht i aksesueshëm nga fëmijët dhe prindërit.

KMD-ja vlerëson nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të grupmohës 3-6 vjeç, të regjistruar pranë institucioneve të arsimit parashkollor, vetëm një herë, në fillim të vitit shkollor. Rekomandimi i KMD-së përcakton vetëm nevojën për mësues ndihmës dhe shërbime të tjera, brenda dhe jashtë institucionit arsimor. Referuar mënyrës se si organizohet procesi mësimor në institucionet e arsimit parashkollor, KMD-ja nuk rekomandon numër orësh mësimore, por vetëm nevojën për mbështetje gjatë qëndrimit të fëmijës në institucionin arsimor.

## **Vlerësimi i nxënësve të regjistruar në institucionet e arsimit special**

Komisioni multidisiplinar vlerëson me kërkesë të drejtorisë së institucionit të arsimit special, nxënësit e regjistruar për herë të parë në këtë institucion. Në këtë rast, pasi vlerëson nevojat arsimore të nxënësve, komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar, vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme do të sillte vështirësi për integrimin, zhvillimin dhe arsimimin e fëmijës me AK. Krahas llojit të arsimimit, komisioni multidisiplinar rekomandon edhe:

- llojin e programit mësimor me të cilin do të punojë nxënësi;
- shërbime të tjera të nevojshme brenda dhe jashtë institucionit.

Komisioni, në këtë rast, nuk rekomandon për numrin e orëve me mbështetje të mësuesit ndihmës, pasi, për shkak të mënyrës se si janë të organizuara këto institucione, mësuesi ndihmës është i integruar pothuajse në të gjitha klasat e krijuara.

## **Vlerësimi i nxënësve me kërkesë të përsëritur të personit që ushtron përgjegjësinë prindërore ose të drejtorit të institucionit arsimor**

Në rastet kur KMD-ja ka vlerësuar nxënësin me aftësi të kufizuara në institucionin arsimor të zakonshëm dhe, referuar nevojave të fëmijës, ka rekomanduar që fëmija të ndjekë arsimin special dhe prindi e ka refuzuar, KMD-ja ndjek procedurën, si vijon:

- Rivlerëson nevojën e fëmijës në arsimin e zakonshëm.

- Jep rekomandime për orët që do të mbështetet me mësues ndihmës, kohën e qëndrimit në IA, objektivat mësimorë dhe sjellorë të PEI-t, shërbime të tjera që mund t'i ofrohen fëmijës brenda dhe jashtë IA-së.

KMD-ja ruan në dosjen e fëmijës, të dy rekomandimet e dhëna dhe refuzimin me shkrim të prindit për ndjekjen e arsimit special.

Komisioni orienton prindin për raste të veçanta, kur rekomandimet e dhëna prej tij nuk janë zbatuar nga ana e tyre dhe kanë penguar zhvillimin e fëmijës, ecurinë e procesit mësimor për nxënësin me AK dhe nxënësit e tjerë në klasë.

## **Vlerësimi i nxënësit që është regjistruar në shkollë mbi moshën e parashikuar në ligj**

Në raste të veçanta, kur fëmija nuk ka ndjekur arsimin e detyruar për shkaqe të përlegjura shëndetësore, ai gëzon të drejtën për t'u arsimuar dhe prindi/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore bën kërkesë pranë njësisë arsimore vendore për regjistrimin në shkollë të fëmijës. Njësi arsimore vendore kryen regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe cakton klasën, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (rekomandohet vendosja në klasë me bashkëmoshatarët ose një vit më poshtë se mosha). Pas regjistrimit, drejtori i institucionit arsimor bën kërkesë për vlerësimin e nevojave arsimore nga komisioni multidisiplinar. KMD-ja mund të japë rekomandime për:

- Llojin e arsimit (i zakonshëm ose i specializuar).
- Llojin e programit mësimor (programi i zakonshëm i klasës, program i reduktuar ose plan edukimi i individualizuar (PEI)).
- Nevojën për mësues ndihmës. Nëse vlerësohet prania e nevojës për mësues ndihmës, atëherë përcakton edhe numrin e orëve mësimore me mbështetje nga mësuesi ndihmës.
- Nevojën për përdorimin e klasës burimore. Nëse vlerësohet nevoja e përdorimit të klasës burimore, KMD-ja rekomandon kohën e përdorimit të saj.
- Shërbime të tjera mbështetëse jashtë IA-së.

# NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT PËR AFTËSINË E KUFIZUAR NË IA

---

Komisioni ngrihet, funksionon dhe zbaton detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni i AK-së brenda IA-së, ngrihet nga drejtori i institucionit, nëse në institucion ndjek mësim, qoftë edhe vetëm një nxënës me AK. Komisioni mund të ngrihet çdo fillim viti, nëse vlerësohet nevoja për ndryshimin e anëtarëve të tij. Kryetar i komisionit të AK-së të shkollës është punonjësi i shërbimit psiko-social. Në institucione arsimore ku ka dy punonjës (psikolog dhe punonjës social), kryetar komisioni është psikologu, punonjësi social është anëtar i komisionit.

Komisioni i AK-së brenda IA-së, mbledhet disa herë gjatë viti shkollor (sipas nevojave dhe në interesin më të lartë të fëmijës) për:

- a. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të shkollës për AK-në.
- b. Udhëzimin e mësuesve për hartimin e planeve PEI dhe miratimin e tyre.
- c. Vlerësimin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas programit mësimor më të cilin nxënësi mëson, tri herë në vit, në fund të çdo periudhe.
- d. Hartimin e orarit mësimor për mësuesit ndihmës.

Mund të ketë raste, kur për nxënësin me aftësi të kufizuara, komisioni multidisiplinar ka rekomanduar mësimin me programin e zakonshëm të klasës. Në këto raste, për nxënësin, referuar nevojave të vlerësuara, hartohet ose jo PEI në aspektin sjellor. Komisioni i AK-së në shkollë, në fund të çdo periudhe, vlerëson, bazuar mbi planin sjellor ose mbi ecurinë në bazë të programit të zakonshëm. Në rastet kur për nxënësin nuk është i nevojshëm hartimi i planit sjellor, komisioni e harton vlerësimin e periudhës në formë procesverbali ose raporti të shkurtër.

Komisioni jep rekomandime, duke vlerësuar nevojat e fëmijës për lejin ose jo të shoqërimit të nxënësit në mjedisin e shkollës nga prindi ose nga persona kujdesi të autorizuar prej tyre, duke vlerësuar mbi ato nevoja të fëmijës, që kërkojnë ose jo shoqërim të domosdoshëm.

Për rastet kur komisioni del me vendim për lejin e shoqërimit të fëmijës nga prindi ose një person i autorizuar, komisioni depoziton pranë drejtorisë së IA-së dokumentacioni përkatës:

- a. Kërkesën e prindit për shoqërimin e fëmijës, me arsyetimin përkatës dhe autorizimin për personin përkatës.
- b. Rekomandimin e komisionit për lejin e tyre.
- c. Fotokopje të mjetit të identifikimit të personit që e shoqëron.
- d. Deklaratë të shoqëruesit që merr përsipër shoqërimin e fëmijës brenda shkollës (për ato raste kur shoqërues nuk është prindi).
- e. Dëshmi penaliteti për personin e caktuar shoqërues.

Komisioni i AK-së, në bashkëpunim me drejtorinë e IA-së, paraqet në çdo fillim të vitit shkollor, kërkesën për vlerësim dhe/ose rivlerësim nevojash për çdo nxënës që ndjek mësimin në atë institucion. Komisioni i AK-së vlerëson në vazhdimësi, nevojat e nxënësve dhe paraqet kërkesë për rivlerësim nevojash, në çdo moment të vitit shkollor, kur vlerëson se nevojat e nxënësit kanë ndryshuar.

Komisioni i AK-së, në bashkëpunim me drejtorin e IA-së, organizon ndarjen e mësuesve ndihmës, orarin mësimor, në përputhje me rekomandimet e komisionit multidisiplinar, të ZVAP-së.

# KLASAT BURIMORE

---

Nxënësi me AK e përdor këtë mjedis, vetëm sipas rekomandimeve të KMD-së pranë ZVAP-së dhe rekomandimit të punonjësit të shërbimit psiko-social të shkollës për raste të veçanta. Kjo klasë përdoret nga mësuesi ndihmës, kur nxënësi duhet të marrë koncepte apo njohuri të reja ose kur shfaq problematika të sjelljes, të cilat nuk mund të menaxhohen brenda klasë gjithëpërfshirëse.

Këto klasa iu shërbejnë mësuesve ndihmës, që brenda normës së tyre mësimore, të punojnë në grup me nxënësit që mbështesin, duke krijuar *grupimin e tyre sipas klasave I-III, IV-V, VI-IX dhe X-XII*.

# SHTOJCA

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_./\_\_\_/20\_\_

## Shtojca 1 – Ngritja e komisionit për nxënësit me aftësi të kufizuara nga institucioni arsimor

Bazuar në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, kreun XIV, neni 83, pika 1, komisioni përbëhet nga:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Detyra
1.		Psikolog i shkollës	Kryetar/e
2.		Punonjës social	Anëtar/e
3.		Mësues AF	Anëtar/e
4.		Mësues AMU	Anëtar/e
5.		Mësues AMU	Anëtar/e
6.		Mësues ndihmës	Anëtar/e

Titullari i institucionit arsimor

\_\_\_\_\_  
(emër mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

\_\_\_/\_\_\_/20\_\_  
(data)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_./\_\_\_/20\_\_

## Shtojca 2a – Plani vjetor i KMD-së

Nr.	Veprimtaritë	Afati kohor	Personi përgjegjës	Bashkëpunime institucionale
1.				
2.				
3...				

**HARTOI**

**Komisioni multidisiplinar**

Kryetari/ët

\_\_\_\_\_  
(emër mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

**MIRATOI**

**Titullari i ZVAP-së**

\_\_\_\_\_  
(emër mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

\_\_\_/\_\_\_/20\_\_

(data)

**Përshkrimi:** Ky plan është një model se si mund të planifikohet puna vjetore e KMD-së, por KMD-ja mund të planifikojë veprimtarinë e saj, në varësi të specifikave, të numrit të nxënësve me AK dhe të nevojave të fëmijëve dhe të institucioneve arsimore lidhur me aftësinë e kufizuar.

Synimi: Arsimimi dhe integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat gjithëpërfshirëse.

Objektiva:

1. Të sigurohet mbështetja dhe mundësia e arsimimit për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, duke i dhënë prioritet arsimit gjithëpërfshirës.
2. Të rriten aftësitë sociale dhe të të nxënësve të fëmijët me AK, që janë pjesë e institucioneve të arsimit parauniversitar.
3. Të identifikohen dhe të vlerësohen nevojat e fëmijëve me AK, nga komisioni multidisiplinar në ZVAP, në bashkëpunim me komisionet e aftësisë së kufizuara në IA.
4. Të rriten kapacitetet e stafeve mësimdhënëse, drejtuese dhe mbështetëse, në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_. \_\_. 20\_\_

## Shtojca 2b – Model plani vjetor i KMD-së

Nr.	Veprimtaritë	Afati kohor	Personi përgjegjës	Bashkëpunime institucionale
1.	Ngritja ose rinovimi i Komisionit Multidisiplinar të ZVAP-së.	Sipas nevojës	ZVAP	
2.	Planifikimi i veprimtarive të KMD-së në zbatim të “Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara”.	Shtator	KMD	ZVAP
3.	Mbledhja e të dhënave mbi ngritjen dhe funksionimin e komisioneve për AK në IA të ZVAP-së.	Shtator	KMD	SHPS në IA
4.	Krijimi i bazës së të dhënave për nxënësit me AK, në IA të ZVAP-së.	Shtator	KMD	Drejtues të IA
5.	Përditësimi i dosjeve individuale të fëmijë të vlerësuar.	Gjatë periudhave të vlerësimit	KMD	Komisionet e AK dhe SHPS në IA
6.	Përpunimi të dhënave statistikore për nxënësit me AK sipas shkollave, klasave, moshës dhe diagnozave përkatëse.	Në përfundim të procesit të vlerësimit	KMD	ZVAP
7.	Përcjellje e informacionit statistikor për ZVAP-në.	Në fund të çdo periudhe vlerësimi.	KMD	ZVAP
8.	Takim pune me komisionin multidisiplinar të ZVAP-së.	Të paktën 3 herë gjatë vitit	KMD	KMD, ZVAP

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Roli dhe përgjegjësitë e komisionit në arsimimin e nxënësve me AK.</li> <li>▪ Shqyrtimi i kërkesave për vlerësim dhe rivlerësim të nxënësve me AK.</li> <li>▪ Dhënia e rekomandimeve përkatëse për çdo nxënës.</li> <li>▪ Diskutimi i problematikave të hasura gjatë vlerësimit.</li> </ul>	dhe sipas nevojave		
9.	Hartimi dhe përcjellja e rekomandimeve për nxënësit e vlerësuar nga KMD-ja.	Në përfundim të çdo periudhe vlerësimi	KMD	KMD, ZVAP
10.	Shkëmbime përvojash, eksperiencash midis kolegësh, mbi teknika dhe metoda në mësimdhënie, për lehtësimin e punës me nxënësit me AK në AF, AMU dhe AML.	Gjatë vitit shkollor	KMD	Rrjetet profesionale

**HARTOI**

**Komisioni multidisiplinar**

Kryetari/ët

\_\_\_\_\_

*(emër mbiemër)*

\_\_\_\_\_

*(nënshkrimi)*

**MIRATOI**

**Titullari i ZVAP-së**

\_\_\_\_\_

*(emër mbiemër)*

\_\_\_\_\_

*(nënshkrimi)*

\_\_\_/\_\_\_/20\_\_\_

*(data)*

### Shtojca 3 - Tabela për bazën e të dhënave të KMD-së

Nr.	IA	Data e vlerësimit	Emër Mbiemër	Klasa	F/M	Diagnoza sipas raportit mjekësor	Lloji i raportit mjekësor	Lloji i arsimit	Lloji i programit	Nevoja për mësues ndihmës	Orë/ javë
1.											
2.											
3...											

**Komisioni multidisiplinar**

Psikolog

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Punonjës social

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mjek peditër

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Psikolog

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mësues i arsimit special

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_ . \_\_\_ .20\_\_

## Shtojca 4 – Rekomandim për ndjekjen e arsimit të zakonshëm

Drejtuar: Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Në zbatim të urdhrin nr.31, datë 28.1.2020, kreu XIV “Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara”, Komisioni Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar në ZVAP \_\_\_\_\_, vlerësoi nxënësin \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, në klasën \_\_\_\_\_, me diagnozën: \_\_\_\_\_.

Vlerësimi u krye në prani të prindit, mësuesit ndihmës, psikologut/punonjësit social të shkollës.

Në përfundim të vlerësimit të nevojave arsimore, të ecurisë në procesin mësimor- edukativ, të përshtatjes, të integritit në shkollë, të kohës së përqendrimit, të nivelit të pavarësisë gjatë procesit mësimor dhe të problematikave sjellore që karakterizojnë diagnozën, komisioni rekomandon:

- Arsimi që rekomandohet të ndjekë fëmija :**
- Arsim i zakonshëm
  - Arsim special
- Programi mësimor:**
- Plan Edukativ Individual
  - Kurrikul e përshtatur
  - Kurrikul standarde e klasës
- Mësues ndihmës:**
- Të asistohet nga mësues ndihmës \_\_\_\_ orë/javë
  - Të qëndrojë i pashoqëruar në klasë
  - Të asistohet edhe nga prindi kujdestar ose familjarë, për kryerjen e nevojave personale

**Përdorimi i klasës  
burimore:**

Vetëm për dhënien e koncepteve të reja (jo më shumë se një orë mësimore në ditë)

Vetëm kur shfaq agjitim dhe problematika sjellore

Nuk paraqet nevojën për përdorimin të klasës burimore

**Shërbime të tjera  
jashtë IA-së:**

Terapi zhvillimi

Terapi sjellore

Logopedi

*Shënim : Institucioni arsimor i jep prindit/personit që ushtron përgjegjësinë prindërore një kopje të këtij rekomandimi.*

**Komisioni multidisiplinar**

Psikolog

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Punonjës social

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mjek peditër

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Psikolog

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mësues i arsimit special

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_ . \_\_\_ .20\_\_

## Shtojca 5 – Rekomandim për ndjekjen e arsimit special

Drejtuar: Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Në zbatim të urdhrit nr.31, datë 28.1.2020, kreu XIV “Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara”, Komisioni Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar në ZVAP \_\_\_\_\_, vlerësoi nxënësin \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, në klasën \_\_\_\_\_, me diagnozën: \_\_\_\_\_.

Vlerësimi u krye në prani të prindit, mësuesit ndihmës, psikologut/punonjësit social të shkollës.

Mbështetur në “Rregullore për funksionimin e IAP-së”, kreu XIV, neni 80, “Për Arsimimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara”, në përfundim të procesit të vlerësimit komisioni multidisiplinar rekomandon:

Komisioni pas vlerësimit të aftësive për përvetësimin e programit mësimor-edukativ si dhe të elementeve sjellore që nxënësi shfaq gjatë procesit të vlerësimit, rekomandon që nxënësi \_\_\_\_\_ të vijojë të ndjekë arsimin special, pasi shfaq dukshëm nevojën për ndërhyrje më të specializuar dhe një mjedis që i përgjigjet më mirë nevojave të tij, për të bërë të mundur rritjen e kapaciteteve të të nxënësit dhe menaxhimin e problematikave të sjelljes që nxënësi manifeston.

Krahas rekomandimit të mësipërm, komisioni gjithashtu sugjeron:

- Ndjekje të vazhdueshme të nxënësit me plan PEI në shkollë.
- Këshillim të vazhdueshëm mësues-psikolog-prind.



Shënim : Institucioni arsimor i jep prindit/personit që ushtron përgjegjësinë prindërore një kopje të këtij rekomandimi.

### **Komisioni multidisiplinar**

	Psikolog	
<i>(emër mbiemër)</i>		<i>(nënshkrimi)</i>
	Punonjës social	
<i>(emër mbiemër)</i>		<i>(nënshkrimi)</i>
	Mjek pediatër	
<i>(emër mbiemër)</i>		<i>(nënshkrimi)</i>
	Psikolog	
<i>(emër mbiemër)</i>		<i>(nënshkrimi)</i>
	Mësues i arsimit special	
<i>(emër mbiemër)</i>		<i>(nënshkrimi)</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_ . \_\_\_ .20\_\_

## Shtojca 6 – Rekomandim për pajisjen me raport mjeko-ligjor

Drejtuar: Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Në zbatim të urdhrin nr.31, datë 28.1.2020, kreu XIV “Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara”, Komisioni Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar në ZVAP \_\_\_\_\_, vlerësoi nxënësin \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, në klasën \_\_\_\_\_, me diagnozën: \_\_\_\_\_.

Vlerësimi u krye në prani të prindit, mësuesit ndihmës, psikologut/punonjësit social të shkollës.

Në përfundim të vlerësimit të nevojave arsimore, të ecurisë në procesin mësimor- edukativ, të përshtatjes, të integritit në shkollë, të kohës të përqendrimit, të nivelit të pavarësisë gjatë procesit mësimor dhe të problematikave sjellore, komisioni rekomandon:

- Të vlerësohet nga specialistët përkatës, për t’u pajisur me raport mjeko-ligjor me diagnozë të specifikuar, për të përfituar mësues ndihmës, sipas kërkesës që i ka paraqitur komisionit multidisiplinar të aftësisë së kufizuar.

*Shënim : Institucioni arsimor i jep prindit/personit që ushtron përgjegjësinë prindërore një kopje të këtij rekomandimi.*

**Komisioni multidisiplinar**

Psikolog

(emër mbiemër)

(nënshkrimi)

Punonjës social

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mjek peditër

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Psikolog

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*

Mësues i arsimit special

*(emër mbiemër)*

*(nënshkrimi)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_. \_\_. 20\_\_

## Shtojca 7 – Vlerësimi periodik nga komisioni i shkollës për AK

Emri Mbiemri:		Klasa:	
Periudha:		Gjinia:	
Diagnoza:		Viti shkollor:	_____ - _____
Numri i orëve me mësues ndihmës:		_____ orë/javë	
Lloji i raportit:			

Fusha	Rezultatet e pritshme të PEI-t	Do të përforcohet rezultati i të nxëniet? Po/Jo	Niveli i arritjeve të PEI-t (1-5)
Gjuhët dhe komunikimi			
Matematikë			

Shkencat e natyrës			
Shoqëria dhe mjedisi			
Arte			
Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti			

**Përshkrimi i niveleve të arritjeve:**

---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---

Nr.	Treguesi i vlerësuar	Niveli i arritjeve				
		APK (1)	ANP (2)	AK (3)	ASHK (4)	ASH (5)
1.	Frekuentimi i shkollës.					
2.	Qëndrimi në klasë (koha e plotë, e pjesshme etj.).					
3.	Sjellja në klasë gjatë mësimit.					
4.	Aftësia verbale/shprehëse.					
5.	Aftësia njohëse/konjitive.					
6.	Aftësia për të shkruar me të diktuar.					
7.	Aftësia për të shkruar me të kopjuar.					
8.	Pjesëmarrja, sjellja dhe qëndrimi në aktivitete.					
9.	Kujdesi ndaj vetes dhe higjiena personale.					
10.	Arritja e përgjithshme e rezultateve të nxënimit.					
11.	Arritja e përgjithshme e rezultateve të pritshme sjellorë.					

#### Komisioni i shkollës për nxënësit me AK

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Detyra	Nënshkrimi
1.	_____	Psikolog i shkollës	Kryetar/e	_____
2.	_____	Punonjës social	Anëtar/e	_____
3.	_____	Mësues AF	Anëtar/e	_____
4.	_____	Mësues AMU	Anëtar/e	_____
5.	_____	Mësues AMU	Anëtar/e	_____
6.	_____	Mësues ndihmës	Anëtar/e	_____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Institucionit Arsimor “ \_\_\_\_\_ ”

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_ . \_\_\_ .20\_\_

## Shtojca 8 – Kërkesë për vlerësim nga IA-ja

Mbështetur në urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, kreu XIV, neni 80, pika 5 dhe kërkesën e prindërve, kërkojmë vlerësimin e nxënësve sipas listës në vijim, me qëllim:

- caktimin e mësuesve ndihmës për këta nxënës,
- caktimit të orëve që këta mësues duhet të punojnë me secilin prej tyre.

Po ju dërgojmë listën e nxënësve me aftësi të kufizuara, të pajisur me raportet mjekoligjore.

Nr.	Emër Mbiemër	Gjinia	Klasa	Diagnoza
1.				
2.				
3.				

**Kryetar i komisionit për nxënësit me AK**

(emër mbiemër)

(nënshkrimi)

**Titullari i institucionit arsimor**

(emër mbiemër)

(nënshkrimi)

# Shtojca 9 - Kërkesë për vlerësim nga prindi

Qyteti, më \_\_\_\_\_.20\_\_

## KËRKESË

Drejtuar: \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit Nr.69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, kreu XI "Arsimi i fëmijëve me Aftësi të Kufizuar", të udhëzimit të përbashkët nr.22, datë 27.7.2022 "Për vitin shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar", bazuar në urdhrin nr.31, datë 28.1.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kreu XIV, "Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar", si dhe në përputhje me të gjitha kartat e të drejtave të njeriut dhe me konventën ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

Unë \_\_\_\_\_, prind/kujdestar ligjor

(emri mbiemri i prindit/ kujdestarit ligjor)

i fëmijës \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_,

(emri mbiemri i fëmijës)

(dd/ mm/ vvvv)

## Kërkoj:

Vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijës tim \_\_\_\_\_, nga komisioni multidisiplinar, duke u mbështetur në raportin mjekësor dhe lejoj punonjës të ShPSSH-ës të vlerësojë, të monitorojë dhe të ndërhyjë, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

\_\_\_\_\_  
(emër mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARA XXXXX

Nr. \_\_\_ prot.

Qyteti, më \_\_\_ . \_\_\_ .20\_\_

## Shtojca 10 – Formulari i vlerësimit të gjendjes fillestare për nxënësit me AK për klasat I-XII<sup>1</sup>

### I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË NXËNËSIT/FËMIJËS

<b>Data e hapjes:</b>	
<b>Institucioni arsimor:</b>	
<b>Klasa:</b>	

<b>1. Emër mbiemër:</b>			
<b>2. Datëlindja/mosha:</b>			
<b>3. Diagnoza:</b>			
<b>4. Diagnoza shoqëruese:</b>			
<b>5. Lloji i raportit:</b>	<b>KMCAP</b>	<b>KML</b>	<b>Tjetër</b>
<b>6. Data e raportit:</b>	___/___/20__	<b>7. Afati i vlefshmërisë:</b>	
<b>8. Telefon:</b> _____	<b>9. Adresa:</b>		

<sup>1</sup> Të dhënat e plotësuara në këtë instrument, do të trajtohen në respektim të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Informacioni i mbledhur nga ky instrument, do të përdoret vetëm për qëllime vlerësimi, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Përpunimi i të dhënave të deklaruara, në kundërshtim me qëllimin e sipërcituar, përbën kundërvajtje administrative, sipas nenit 39, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

## II. TË DHËNA PËR JETËN DHE HISTORIKUN E DIAGNOSTIKIMIT

10. Kushtet social-ekonomike në të cilat jeton nxënësi (Numri i anëtarëve të familjes, gjendja social-ekonomike e familjes, kush kujdeset më shumë për fëmijën, me kë është më i lidhur fëmija?).	
11. Historiku i diagnostikimit dhe i trajtimit (mosha e diagnostikimit fillestar, trajtimet e marra).	
12. Nevoja specifike lidhur me qëndrimin në shkollë (largimi nga mjedisi, çfarë e qetëson/shqetëson).	
13. Si ka qenë ecuria e nxënësit gjatë periudhës që ka frekuentuar shkollën (përshtatja, të nxënit, sjellja, reagimi emocional)?	
14. A shfaq fëmija elemente të sjelljes agresive? Nëse PO, në çfarë kushtesh?	

**15. Gjendja e fëmijës deri tani rezulton:**  e qëndrueshme  në përkeqësim  në përmirësim.

**16. Fëmija po merr ndonjë lloj mjekimi?**  Po  Jo

Nëse po, specifikoni llojin e mjekimit që po përdor:

.....  
.....

**17. Përdor ndonjë mjet ndihmës, si:**

- a. syze  Po  Jo
- b. aparat dëgjimi  Po  Jo
- c. karrocë  Po  Jo
- d. tjetër .....

**18. Është duke marrë ndonjë lloj trajtimi?**

- 1. Fizioterapi  Po  Jo
- 2. Terapi zhvillimi  Po  Jo
- 3. Terapi sjelljeje  Po  Jo

4. Logopedi                     Po     Jo  
 5. Terapi grupi                 Po     Jo  
 6. Tjetër .....

*Ky formular vlerësimi është ndërtuar bazuar në **Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit: Versioni për Fëmijët dhe adoleshentët (KNF-FR)**, nga i cili janë përzgjedhur ata tregues që ndihmojnë në vlerësimin e nevojave arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Ky vlerësim realizohet nga komisioni multidisiplinar për aftësinë e kufizuar, i ngritur pranë çdo njësie arsimore vendore.*

### III. VLERËSIMI SIPAS FUSHAVE

**Udhëzime për plotësim:** Më poshtë janë listuar treguesit për funksionet mendore, për të cilat vlerësohet prania ose jo e problemit dhe përcaktohet cilësori (shkalla e dëmtimit) sipas shkallës në vijim:

- 0 problemi MUNGON (nuk ka, mungon, i papërfillshëm);
- 1 problem I LEHTË (i pakët, i ulët);
- 2 problem MESATAR (mesatar, i konsiderueshëm);
- 3 problem I RËNDË (i lartë, ekstrem);
- 4 problem I PLOTË (total).

Funksionet mendore	Është problemi?	Cilësori
<b>Funksionet globale mendore</b>		
<b>Vetëdija</b> (aftësia për të kuptuar dhe për të qenë i vetëdijshëm për eksperiencat, mendimet ndjenjat, veprimet dhe mjedisin që e rrethon).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
<b>Orientimi</b> (në kohë, hapësirë, persona).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
<b>Intelekti</b> (aftësia për të kuptuar, përpunuar informacion, zgjidhur probleme, mësuar përvoja etj.).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
<b>Aftësia për t'u përfshirë</b> (shkathtësia për të ndërvepruar me të tjerët, për t'u angazhuar në grupe sociale, empatia, toleranca, etj.).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
<b>Funksionet e gjumit</b> (vështirësi për vendosjen e një rutine të rregullt të gjumit).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
<b>Funksionet mendore specifike</b>		
<b>Vëmendja</b> (aftësia për t'u përqendruar, për të kuptuar dhe për të reaguar në mjedisin e klasës).	<input type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	

<b>Kujtesa</b> (aftësia për të ruajtur dhe për të përdorur informacionin).	○Po ○Jo	
<b>Funksionet psikomotorë</b> (koordinimi i lëvizjeve të trupit që përfshin lidhjen midis proceseve mendore dhe aktiviteteve motorike).	○Po ○Jo	
<b>Funksionet emocionale</b> (aftësia për të shprehur dhe për të kontrolluar emocionet në përputhje me kontekstin).	○Po ○Jo	
<b>Funksionet e perceptimit</b> (aftësia për të perceptuar rrezikun, ndjesitë, kufijtë socialë).	○Po ○Jo	
<b>Funksionet e mendimit</b> (aftësia për të kuptuar, për të analizuar dhe për të përpunuar informacionin në përputhje me moshën).	○Po ○Jo	
